



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës: Zyrtar i lartë për Autorizimin e Pagesave (2 Pozita)

Ref: RN00003609

Njësia Organizative: Drejtoria e Autorizimit të Pagesave - AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli profesional

Koeficienti: 8

Qëllimi i vendit të punës:

- Zyrtari i Lartë për Autorizimin e Pagesave –Nacionale/nga donacionet është përgjegjës për pranimin, regjistrimin dhe përpunimin e kërkesës për pagesë , kontrollin administrative të kërkesës për pagesë, përgatitjen e kërkesës për kontroll në teren, analizën e raportit të kontrollit, kalkulimin e shpenzimeve, përgatitjen e dokumentave për autorizimin e kërkesës për pagesë si dhe llogaritjen e shumës totale për pagesë.Përpunimi i kërkesave për pagesa sipas doracakeve dhe instruksioneve, menaxhimi i regjistrave dhe përgatitja e raporteve nga fusha e punës.Monitorimi i bazës ligjore nga fusha e punës, pjesëmarrje në përgatitjen e doracakeve, instruksioneve, letrat e informimit, vendimet dhe listat e kontrollit.

Detyrat kryesore:

1. Pranimi dhe regjistrimi i kërkesës për pagesë,kontrollimi I kërkesave për pagesë nëse janë të kompletuara – kontrolli administrative 10%
2. Kontrolli i kriterëve të pranueshmerisë së kërkesës për pagesë nëse janë ne përputhje me doracak dhe listat e kontrollit, zbatimi I parimit në 4 sy 10%
3. Përgatitja e kërkesave për kontroll ne teren, 10%
4. Analiza e raportit të kontrollit në teren, vlerësimi i faturave dhe transfereve bankare sipas çmimores standarde të AZHB-së dhe realizimit të projekteve. 35%
5. Mirëmbajtja e të dhenave në softverin për menaxhimin e pagesave pjesa e autorizimit të pagesave, 10%
6. Pergatitja e Letrave Informuese dhe Vendimeve për perfituesit sipas kriterëve nga programi nacional , 5%
7. Bashkëpunon me sektoret dhe drejtorit tjera te AZHB-së, zbaton detyra tjera sipas,instruksioneve nga mbikqyrësi, 10%
8. Pjesëmarrje në pregaditjen e doracakëve,instruksioneve letrat e kontrollit,listat e kontrollit 10%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma Universitare: **Shkenca Ekonomi, Bujqësi , Juridik ;**
- Përvoja në punë: 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri paraprake në fushën e administratës publike;
- Njohja e punës me kompjuter dhe aftësitë për të përdorur me efekt: Windowsin, World, Exel Access-in, dhe Microsoft Office;
- Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Data e shpalljes së konkursit me: 22.08.2018

Data e mbylljes së konkursit me: 05.09.2018

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 16 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.